



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

**VENDIM
Nr. 170, Datë 26.10.2017**

**MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “BINDI” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe neneve 4, pika 1, gërma “e” dhe 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të Shoqërisë “Bindi” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Bordi i ERE me vendimin Nr.146, datë 18.09.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “BINDI” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike

Aplikimi i shoqërisë “Bindi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë Shoqërinë “Bindi” sh.p.k., në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI